

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigje ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	08.01.2025	Kërkesë për sigurim padie drejtuar gjyqtarit të çështjes.	09.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për sigurim padie të dërguar në rrugë elektronike, Ju informojmë se: Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, neneve 154 e vijues, kërkesat për marrjen e masave për sigurimin e padisë duhet të depozitohen pranë sekretarisë së gjykatës dhe të jenë të nënshkruara nga vetë paditësi ose nga mbrojtësi i autorizuar me prokurë përfaqësimi. Gjithashtu, bashkë me kërkesën, është e nevojshme të depozitohen aktet provuese në formatin e tyre origjinal, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Vëmë në dijeni se Kodi i Procedurës Civile nuk parashikon mundësinë e depozitimit të kërkesave për sigurimin e padisë nëpërmjet postës elektronike. Për këtë arsye, ju ftojmë të dorëzoni dokumentacionin përkatës pranë sekretarisë së gjykatës në formatin e kërkuar.	E plotë	S'ka
2	09.01.2025	Sa urdhra mbrojtje janë lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për vitin 2024?	14.01.2025	Sipas statistikave dhe sistemit ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për vitin 2024, janë paraqitur 125 kërkesë padi për lëshim Urdhër Mbrojtje, ku në 64 prej tyre Gjykata ka vendosur lëshimin e Urdhërit të	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Mbrojtjes.		
3	14.01.2025	Kërkoj kopje të plotë të akteve të dosjes penale dhe transkript i procesverbaleve të seancave gjyqësore për të pandehurin G.K.	17.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj, ku kërkon kopje të akteve të dosjes penale dhe transkript të procesverbaleve të seancave gjyqësore, në çështjen me të pandehur G. K. si përfaqësues i tij, ju bëjmë me dije se nga ana e gjyqtarit të çështjes është refuzuar kërkesa e paraqitur nga ju.	E refuzuar	S'ka
4	15.01.2025	Kërkoj të di a ka dalë datë gjyqi për paditëse Xh.K. dhe pale e paditur F.K., me gjyqtar Renis Sheshi.	17.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon nëse ka ndonjë datë gjyqi për çështjen me palë paditëse Xh.k. dhe palë e paditur F.K., ju bëjmë me dije se në momentin që do caktohet data, da të njoftoheni nga sekretaria gjyqësore në adresën e dhënë nga ju në kërkesë padi.	E plotë	S'ka
5	20.01.2025	Kërkoj tre kopje vendimi me pullë taske për shtetasin S.G.	22.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj të dërguar me datë 20.01.2025, ku kërkon vendimin nr. S'ka datë 27.12.2024, të pajisur me pullë takse, ju bëjmë me dije se vendimi në fjalë ju është dërguar në origjinal i nënshkruar rregullisht konform parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile. Ky fakt gjen pasqyrim dhe në emailin tuaj. Në kushtet kur bëhet fjalë për një vendim të ndërmjetëm, jo përfundimtar për të cilin nuk parashikohet as ankim i veçantë,	E refuzuar	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				vlerësojmë se kërkesa juaj nuk gjen mbështetje në ligj e për rrjedhojë duhet të refuzohet.		
6	20.01.2025	Si përfaqësues i B.K., kërkoj datën e seancës gjyqësore me paditës shtetasin F.M., dhe palë e tretë B.T.	22.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkonti të dini nëse është caktuar datë për çështjen gjyqësore me padites F.M. dhe Person i Tretë B.T., pas verifikimit në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, seanca është planifikuar me datë 31.01.2025, ora 09.00.	E plotë	S'ka
7	21.01.2025	Kërkesë për informacion lidhur me çështjet e mëposhtme: 1.Statistika për numrin e çështjeve civile me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar 2024– 31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 617 “Publikimet mashtruese ose të pasakta”, 625 “Përgjegjësia për dëmin jopasuror”, dhe 647/a të Kodit Civil. 2.Statistika për numrin e çështjeve penale me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar 2024– 31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 119 “Fyerja”, 120 “Shpifja”, 121 “Ndërrhyrje të padrejta në jetën private”,143/b“ Mashtrimi Kompjuterik”, 186/a “Falsifikim kompjuterik” të Kodit Penal. 3.Si kanë ndryshuar statistikat e vitit 2024 në raport me vitin 2023 lidhur me këto çështje? 4.Vendimarrja përkatëse për këto çështje, vendime dënimi, pafajësie,	04.02.2025	-Pas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për periudhën nga 1 Janar 2024– 31 Dhjetor 2024 nuk kemi asnjë çështje civile apo penale të regjistruar me palë gazetarë/punonjës të medias për këto nene 617 “Publikimet mashtruese ose të pasakta”, 625 “Përgjegjësia për dëmin jopasuror”, dhe 647/a të Kodit Civil dhe nenet 119 “Fyerja”, 120 “Shpifja”, 121 “Ndërrhyrje të padrejta në jetën private”, 143/b “Mashtrimi Kompjuterik”, 186/a “Falsifikim kompjuterik” të Kodit Penal. -Në vitin 2023 është regjistruar një çështje civile për nenin 625 “Përgjegjësia për dëmin jopasuror”, dhe 647/a të Kodit Civil, ku palë e paditur është palë media dhe rezulton se me vendimin nr.53-2024-3442 datë 11.11.2024 Gjykata e	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		pushimi, pranim apo rrëzim. 5.Informacion mbi numrin e çështjeve të reja për vitin 2024 dhe informacion për sa çështje janë të mbartura. 6.Informacion mbi faktin nëse disponohet një regjistër të dhënash për gazetarët dhe punonjësit e mediave, ku regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj tyre.		Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka vendosur “Pushimin e gjykimit të çështjes”. Në lidhje me regjistrin e të dhënave për gazetarët dhe punonjësit e mediave, ku regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj tyre, nuk disponojmë një të tillë, por në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është një rubrikë e veçantë që plotësohet në momentin e regjistrimit të çështjeve civile, për gazetarë/përfaqësues mediash nëse janë palë apo jo në çështjen e caktuar. Sa më sipër bazuar në ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” vendimi gjyqësorë bashkëngjitur ju dërgohet në formë të anonimizuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të cilat ndodhen në vendimin e mësipërm.		
8	24.01.2025	Kërkoj informacion për çështjen time e cila ka nisur shqyrtimin gjyqësorë në Gjykatën e Shkallës së Parë Laç me palë të paditur B.L.	29.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj, ku kërkon t’ju informojmë për çështjen tuaj ku shpreheni se ka nisur shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë Kurbin, ju bëjmë me dije se sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk rezulton të ketë çështje në emrin tuaj.	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Ju lutemi na dërgoni emrat e palëve ndërgjyqëse si paditës dhe të paditur, që të mund të bëjmë verifikime të mëtejshme, pasi me emrin tuaj nuk figuron çështje e regjistruar në gjykatë.		
9	25.01.2025	Kërkoj procesverbalet e seancave gjyqësore të ndodhur në vendimin nr.675-84 datë 3.7.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin me të dënuar shtetasin G.G., ku janë pyetur dëshmitarët/viktimat.	29.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku në cilësinë e avokatit të shtetasit G.G., kërkon kopje të procesverbaleve gjyqësore të ndodhur në vendimin nr.675-84 datë 3.7.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin me të dënuar shtetasin G.G., ju lutemi na dërgoni prokurën ose akt përfaqësimi nga shtetasi G.G.	E plotë	S'ka
10	27.01.2025	Kërkoj orën e seancës civile me palë paditës A.R. dhe palë e paditur C.R., numrin, konfirmimin e vendodhjes së gjykatës si dhe gjyqtarin e çështjes.	28.01.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon të dini orën e seancës gjyqësore me palë paditës A. R. dhe e paditur C. R., numër çështje ____-____-53-2024, ju bëjmë me dije se seanca gjyqësore është planifikuar me datë 30.01.2025 ora 10:00 me gjyqtar Renis Sheshi, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me adresë Bulevardi "Gjergj Fishta", Lezhë.	E plotë	S'ka
11	30.01.2025	Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor kërkoj informacion mbi çështjes gjyqësore si më poshtë: Palë paditëse Shoqëria “---”shpk, palë e paditur Shoqëria “---”shpk, palë paditëse Shoqëria “---”, palë e paditur Shoqëria “---”shpk,	07.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj si përfaqësues ligjor, ku kërkon informacion për çështjet gjyqësore, ju lutemi na dërgoni aktin e përfaqësimit , në mënyrë që tju vendosim në dispozicion	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		Emrin e gjyqtarit të çështjes? Datën e seancës gjyqësore? Vendimarrjen e gjykatës? (nëse ka)		informacionin e kërkuar.		
12	31.01.2025	Si përfaqësuese ligjore e Shoqërisë “B.P” shpk, kërkoj të informohem për çështjet specifike gjyqësore në të cilat është palë kjo shoqëri.	06.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj si përfaqësuese ligjor, ku kërkon informacion për çështjet gjyqësore, ju lutemi na dërgoni aktin e përfaqësimit , në mënyrë që tju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar.	E plotë	S’ka
13	12.02.2025	Si qytetar dhe pjesëtar i komunitetit të qytetit të Mamurrasit, duke njohur rëndësinë që ka edukimi ligjor, nëpërmjet mundësisë që ofron shkolla qendër komunitare e cila I jep mundësinë komunitetit të bashkëpunojë me institucionet e edukimit kërkoj mundësinë e zhvillimit të një vizite studimore me nxënës të shkollës qendër komunitare 9-vjeçare “Demokracia Mamurras”, të shoqëruar edhe nga përfaqësues të personelit mjekësor.	21.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj, ku kërkon të zhvilloni një vizitë studimore, kërkojmë të na vendosni në dispozicion autorizimin përkatës nga institucioni arsimor në rastin konkret nga Drejtori/esha e Shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, në mënyrë të mund të zhvilloni një vizitë të tillë pranë Gjykatës.	E plotë	S’ka
14	12.02.2025	Kërkon një verifikim në lidhje me dispozitivin e vendimit nr.53-2024----, datë 08.07.2024, që i përket shtetas V.M.	17.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj, ju lutemi na tregoni arsyen për te cilën e kërkon informacionin si dhe na qartësoni specifikisht informacionin që kërkon në lidhje me shtetasen në fjalë.	E plotë	S’ka
15	12.02.2025	Siç jeni në dijeni nëpërmjet kërkesës time kam shprehur interesin dhe kam apilkuar për pozicionin e sekretares gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Deri sot ka kaluar një kohë	21.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, bazuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, Ju sqarojmë si më poshtë: Me shkresën nr.1538 Prot, datë	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		shumë e gjatë nga momenti i aplikimi tim, por nuk jam njoftuar lidhur me rezultatin përfundimtar. Gjithashtu deri më sot me datë 12.02.2025 nga verifikimet në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë por edhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk rezulton të jetë publikuar asnjë njoftim zyrtar lidhur me rezultatin përfundimtar për plotësimin e këtij vendi vakant. Duke qenë se unë kam aplikuar për këtë vend pune bazuar në ligjin “Për të drejtën e informimit” Nr.119/2014, i ndryshuar vendimit i KLGJ-së nr. 622 datë 10.12.2020, Udhëzimi Nr.85 datë 11.03.2021 “Për plotësimin e vendeve vakante të lira në shërbimin civil gjyqësorë nëpërmjet procedurës së lëvizjes, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurimit të hapur, kërkoj të më informoni lidhur me arsyen e njoftimi tim për këtë procedurë aplikimi, fazën e procedurës apo rezultatin përfundimtar duke qenë se nga ana juaj nuk është publikuar asnjë njoftim zyrtar as në faqen e gjykatës dhe as në faqën e KLGJ-së.		02.12.2024 është shpallur për konkurim 1 (një) pozicion pune “Sekretare gjyqësore” kategoria ekzekutive, klasa IV 1, dhe pas verifikimeve paraprake për procedurën e levizjes paralele, ka rezultuar se nuk ka patur aplikime. Më pas është vazhduar me fazën e dytë, atë të permbushjes se kushteve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe ka rezultuar kandidatë të kualifikuar: M. P., A. A. dhe R.R. Për sa më sipër është bërë njoftimi mbi rezultatet e verifikimit paraprak me shkresën nr. 1538/2, datë 26.12.2024 KLGJ-së, ku është cituar se kandidatet M. P. e A.A. janë kandidate nga lista e pritjes (shpallje fitues të datë 07.06.2024) me pikët 75.36 pikë për znj. M. P. dhe 74.96 pikë për znj. A. A. Duke qenë se dy kandidatet M. P. dhe A. A. kanë qenë në liste pritje, vetëm znj. R.R. i është nënshtruar testimit të dates 16.01.2025, nga ku me shkresën nr. 45, datë 17.01.2025 është njoftuar KLGJ, mbi rezultatet përfundimtare të testimit me shkrim, ku znj. R. R. nuk është kualifikuar. Me vendimin nr. 12, datë 29.01.2025 të Këshillit të Gjykatës, është bërë emërimi paraprak i znj. M.P. në pozicionin “sekretare gjyqësore” si kandidate e kualifikuar e para me 75.36 pikë kundrejt vendit të dytë znj. A. A. me 74.96 pike. Gjithashtu, ju sqarojme se, me	
--	--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				vendimin nr. 11, datë 29.01.2025 të Këshillit të Gjykatës është vendosur shpallja e dy pozicioneve të tjera për “sekretare gjyqësore”, për të cilat znj.A.A., është kandidate e vetme nga lista e pritjes, e cila mund të kandidojë sapo këto vende të shpallen, pas kthimit të përgjigjes për listë pritje nga KLGJ.		
16	12.02.2025	Kërkoj informacion si palë e dëmtuar pasi kam bërë denoncim në Komisaratin e Policisë Mirditë me datë 07.10.2024 ndaj shtetas F. B. me akuzën "Dhunë në Familje". Do të doja të dija nëse Prokuroria ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ndonjë kërkesë për gjykim. Nëse po më thoni ju lutem kush gjyqtar/e e ka dhe nëse ka datë gjykimi ?	14.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, rezulton se nuk ka të regjistruar kërkesë për gjykim të ardhur nga Prokuroria, në emër të shtetas F. B., në lidhje me veprën penale “Dhunë në familje”.	E plotë	S’ka
17	13.02.2025	Jetoj në Itali dhe nuk kam mundësi të lëviz. Më ka ardhur një letër njoftim nga gjykata që të paraqitem në Gjykatën e Lezhës por nuk kam mundësi të lëviz sim und të bëhet?	14.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije se si trashëgimtare e viktimës në proces penal keni të drejtën dhe jo detyrimin që të merrni pjesë në seancat e zhvilluara. Nëse keni dijeni rregullisht dhe zgjidhni të mos paraqiteni, gjykimi do vijojë në mungesën tuaj. Po ashtu ju keni të drejtë dhe të përfaqësoheni nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur me prokurë në këtë proces.	E plotë	S’ka
18	20.02.2025	Si avokat mbrojtës i shtetasit G.G., kërkoj procesverbalet e seancave gjyqësore të vendimit penal nr.675-84 datë 03.07.2020 me të dënuar shtetasin	28.02.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për kopje të procesverbaleve, Ju bëjmë me dije se: Porcesverbalet e seancave gjyqësore	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		G.G., me qëllim të kërkesës për lirim me kusht të tij, ku janë pyetur dëshmitarët/viktimat G.Sh., E. Sh., E. Sh., B. Sh., I. Sh., B. Sh., I. Sh.		ku janë pyetur dëshmitarët/viktimat G.Sh., E. Sh., E. Sh., B. Sh., I. Sh., i keni gati dhe mund të paraqiteni pranë sekretarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për ti tërhequr.		
19	28.02.2025	Kërkoj informacion në lidhje me ecurinë e çështjeve të mëposhtme si dhe datat e seancave të ardhshme: 1.Paditës Shoq.”---“ shpk, 2.Shtetasi M. G. kundër V. Gj. 3.Shtetasi M. Ll. kundër ATP	06.03.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon datat e seancave gjyqësore, pas verifikimit në Sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ju bëjmë me dije se: 1.Paditës Shoq.”---“ shpk, seanca është planifikuar me datë 21.03.2025, ora 12:00. 2.Shtetasi M. G. kundër V. Gj., seanca është planifikuar me datë 29.04.2025, ora 12:30. 3.Shtetasi M. Ll. kundër ATP, seanca është planifikuar me datë 24.03.2025, ora 13:00.	E plotë	S’ka
20	07.03.2025	Në cilësinë e përfaqësuesit të zgjedhur të shtetases K.Gj., në kushtet kur kemi marrë dijeni se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur prishjen e vendimit nr.437 datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues, na informoni nëse dosja fizike është sjellë në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe nëse është caktuar trupa e re gjyqësore.	11.03.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije se: sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nuk rezulton të jetë regjistruar çështja civile me palë paditëse K.Gj., dhe palë e paditur F.Gj., ardhur nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

21	11.03.2025	Në cilësinë e avokates së shtetases M.Ç. kërkoj vendimin nr.53-2024-2520 datë 19.8.2025 me pale paditës Gj.Ç. dhe e paditur M.Ç., me objekt “Lëshim UMM”, pasi më nevojitet në çëshjten e zgjidhjes së martesës.	11.03.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon vendimin nr.53-2024-2520 datë 19.8.2025 me pale paditës Gj.Ç. dhe e paditur M.Ç., me objekt “Lëshim UMM”, bashkëlidhur e-mailit ju dërgojmë vendimin e mësipërm.	E plotë	S’ka
22	19.03.2025	Aktualisht është duke u gjykuar çështja civile me paditëse R.M., i paditur B.M., me objekt “zgjidhje martese”. Nëpërmjet emailit ju kam paraqitur deklaratën e mbrojtjes. Kërkoj informacion nëse deklaratat e mbrojtjes që kam paraqitur I është vënë në dispozicion gjyqtarës së çështjes. Në rast refuzimi më ktheni përgjigje me shkrim me qëllim që të paraqes ankim në KLGJ.	21.03.2025	Lidhur me kërkesën tuaj për informacion në kuadër të së drejtës së informimit, ju konfirmojmë se deklaratat e mbrojtjes që keni paraqitur i është vënë në dispozicion gjyqtarës. Më lejoni t’ju bëjmë me dije se gjykata jonë ndjek me përpikmëri të gjitha procedurat ligjore për administrimin e dokumentacionit të paraqitur nga palët, duke respektuar plotësisht të drejtën e informimit. Në lidhje me ankimin e përmendur në rast refuzimi në KLGJ, ju kujtojmë se komunikimi institucional është më efektiv kur bazohet në mirëbesim reciprok. Ndërkohë që e drejta për t’iu drejtuar instancave më të larta mbetet dyshim I pacënueshëm, nuk është nevoja të paraprini kërkesën tuaj të thjeshtë për informacion me paracaktime të mëtejshëm ankimes.	E plotë	S’ka
23	20.03.2025	Kërkoj informacion statistikor në lidhje me paditë e marrëdhënieve të punës punëmarrës (indiv) dhe punëdhëns(shteti/pushtet qëndror/vendor/) për vitet 2023-2025.	28.03.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, në vijim po ju vëmë në dispozicion të dhënat statistikore të gjeneruara nga sistemi ICMIS i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, të cilat lidhen me çështjet që	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				përmbushin kriteret e kërkuara për secilin vit kalendarik: Vitin 2023 janë gjykuar gjithësej 3 (tre) çështje, ku individit ka qenë në cilësinë e punëmarrësit dhe institucionet shtetërore në cilësinë e punëdhënësit ndër të cilat 2(dy) prej tyre është vendosur rrëzim dhe 1(një) pranim. Vitin 2024 janë gjykuar gjithësej 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështje, ku individit ka qenë në cilësinë e punëmarrësit dhe institucionet shtetërore në cilësinë e punëdhënësit ndër të cilat 8(tetë) prej tyre është vendosur pranim, 6 (gjashtë) rrëzim dhe 2 (dy) moskompetencë. Vitin 2025 deri me datë 26.03.2025, janë gjykuar gjithësej 4 (katër) çështje, ku individit ka qenë në cilësinë e punëmarrësit dhe institucionet shtetërore në cilësinë e punëdhënësit ndër të cilat 2(dy) prej tyre është vendosur pranim, 1 (një) rrëzim dhe 1 (një) moskompetencë.		
24	24.03.2025	Kërkoj informacion se në çfarë gjendje është kërkesëpadia që kam bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për zgjidhje martesë.	28.03.2025	Pas verifikimit në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe sekretarisë gjyqësore ju bëjmë me dije se deri tani nuk ka datë të planifikuar për çështjen civile me palë paditëse D.A. me objekt “zgjidhje martesë” për arsye se çështja ndodhet në procedurë shpallje.	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

25	28.03.2025	Në bazë të së drejtës për informim public kërkoj sa më poshtë: Sa kërkesa keni patur gjatë 2023, 2024 dhe Janar-Mars 2025 (emrat e rasteve në shqyrtim dhe nëse është marrë vendim na vini në disponim vendimet) për çështjet me objekt “Prokurori – Njohje vendimi penal i huaj” dhenë nga gjykatat në Britaninë e Madhe për shtetas shqiptar.	07.04.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku kërkonti të dhëna në lidhje me: Numrin e kërkesave penale me objekt “Prokurori – Njohje vendimi penal i huaj”, dhënë nga gjykatat në Britaninë e Madhe për shtetas shqiptarë, për vitet 2023, 2024 dhe periudhën Janar–Mars 2025, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, si dhe vendimet përkatëse nëse ka pasur, Ju bëjmë me dije se: Pas verifikimeve të kryera në sistemin elektronik ICMIS si dhe në regjistrat fizikë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, rezulton si më poshtë: -Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 3 (tre) kërkesa penale të kësaj natyre, të cilat janë përfunduar; -Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 2 (dy) kërkesa penale, prej të cilave një është përfunduar dhe një është ende në shqyrtim; -Gjatë periudhës Janar–Mars 2025 janë regjistruar 2 (dy) kërkesa penale, të cilat aktualisht ndodhen në shqyrtim pranë gjykatës. Në vijim të kësaj përgjigjeje, ju bashkëlidhen vendimet gjyqësore përkatëse të dhëna nga kjo gjykatë, gjithsej 4 (katër).	E plotë	S’ka
----	------------	---	------------	--	---------	------

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Sqarojmë se, pavarësisht se kërkesa juaj synon të identifikojë informacion në lidhje me persona konkretë, të dhënat e përfshira në këto vendime përbëjnë të dhëna personale dhe për rrjedhojë, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dokumentacioni i vënë në dispozicion është anonimizuar në mënyrë që të garantohet mbrojtja e privatësisë së personave të përmendur në aktet përkatëse.		
26	28.3.2025	Për qëllime studimi kërkojmë informacion si më poshtë: Sa është numri i procedimeve të regjistruara në gjykatën tuaj për çështjet me objekt, “Trafikimi i personave të rritur”, parashikuar nga neni 110/a K.Penal, “Trafikimi i të miturve”, parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, dhe “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114 i K.Penal. Vënien në dispozicion të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me këto vepra penale. Lutemi na dërgoni informacion në sa prej rasteve është vendosur pranimi i fajësisë.	10.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr.536 prot, datë 26.03.2025, protokolluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë më nr.323 prot, datë 28.03.2025, ku kërkon numrin e procedimeve të regjistruara në gjykatë, kopjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe në sa prej tyre është vendosur pranimi i fajësisë për veprat penale “Trafikimi i personave të rritur”, “Trafikimi i të miturve”, “Shfrytëzim i prostitucionit”, parashikuar nga nenet 110/a, 114 dhe 128/b të Kodit Penal, për vitin 2024, referuar Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Sipas verifikimit në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				ju bëjmë me dije se: -Për vitin 2024 është regjistruar një çështje penale për veprat penale të parashikuar nga nenet 278/5, 283/2 dhe “Shfrytëzim i prostitucionit”, parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal, çështje e cila me datë 16.12.2024 gjykata ka vendosur: <i>“Pranimin e kërkesave të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë..., Dërgimin në gjyq të çështjes penale për veprat penale të parashikuar nga nenet 278/5, 283/2 dhe 114/2 të Kodit Penal...”</i> Çështja penale e mësipërme aktualisht ndodhet në gjykim në themel pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. -Në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të Kodit Penal nuk rezulton të ketë çështje penale të regjistruar në këtë gjykatë për vitin 2024.		
27	04.04.2025	Si avokate e caktuar nga Dhoma e Avokatisë Tiranë për ndihmë juridike të garantuar nga shteti për shtetasin Gj.Gj., këkoj një kopje të vendimit për shtetasin në fjalë të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.	09.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion apo dokumentacion, ku si avokate e caktuar nga Dhoma e Avokatisë Tiranë për ndihmë juridike të garantuar nga shteti për shtetasin Gj. Gj., ku kërkon vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në emër të shtetasit Gj.Gj., bashkëngjitur emailit ju dërgojmë vendimin datë 29.03.2024 me objekt	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				"Ndihmë juridike për shtetasin Gj. Gj.".		
28	05.04.2025	Si përfaqësues me prokurë i shtetases Xh.M., kërkoi të informohem nëse ka ndonjë proces civil që po zhvillohet aktualisht me objekt “Njohje, pjestim pasurie” apo çështje tjetër që ka të bëjë me pasuritë e trashëgimlënësve të ndjerëve P.M., A.M., J.M.	08.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkoni informacion si përfaqësues me prokurë i shtetases Xh.M. (trashëgimtare ligjore e të ndjerëve P.M. etj.) nëse ka ndonjë proces civil që po zhvillohet aktualisht me objekt “njohje, pjestim pasurie” apo çështje tjetër që ka të bëjë me pasuritë e trashëgimlënësve të sipërcituar, ju bëjmë me dije se: Sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezultoi një çështje civile me palë paditës I. Xh. etj., dhe palë të paditur Xh.M. etj., me objekt “Pjestim pasurie...”, e cila ndodhet në shqyrtim pranë gjyqtar Ilir Përdeda.	E plotë	S’ka
29	08.04.2025	Në mbështetje të Ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”, ju lutemi na dërgoni: Vendimet gjyqësore të skanuara me objekt “Kërkesë për hapje të procedurave të falimentimit”, për periudhën Janar-Mars 2025. Plotësimi i tabelës bashkëngjitur. Dërgimin në vazhdimësi të çdo kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.	08.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkoni vendimet gjyqësore me objekt “ Kërkesë për hapje të procedurave të falimentimit ” për periudhën Janar-Mars 2025 ju bejme me dije se, sipas verifikimeve të kryera në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për periudhën Janar-Mars 2025 nuk rezultoi të ketë kërkesë me objekt “ Kërkesë për hapje të procedurave të falimentimit ”.	E plotë	S’ka
30	10.04.2025	Kërkoi të më dërgoni dokumentat e divorcit.	14.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkoni vendimin gjyqësor, në emrin	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				tuaj me objekt "zgjidhje martese", ju bëjmë me dije se: Vendimet gjyqësore sapo dorëzohen të arsyetuar, komunikohen nga ana e sekretarisë gjyqësore në adresën e përcaktuar nga palët. Ky rregull zbatohet në çdo rast e për rrjedhojë dhe për vendimin të cilit i referoheni.		
31	15.04.2025	Kërkoj informacion për datën dhe orën e gjykimit të çështjes civile me paditëse R.M, I paditur B.M., me objekt “zgjidhje martese”.	16.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon informacion për datën dhe orën e seancës për çështjen me palë paditëse R. M. dhe palë e paditur B. M.me objekt “zgjidhje martese”, ju bëjmë me dije se pas komunikimit me sekretaren e gjyqtares së çështjes, seanca gjyqësore është planifikuar me datë 30.4.2025 ora 11:15, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.	E plotë	S’ka
32	16.04.2025	Do të doja të dija nëse gjyqtari ka nxjerrë dekretin e divorcit nr.23004-01005-2024.	25.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon vendimin e divorcit nr.23004-01005-53-2024 në emrin tuaj ju bëjmë me dije se: Vendimet gjyqësore sapo dorëzohen të arsyetuar, komunikohen nga ana e sekretarisë gjyqësore në adresën e përcaktuar nga palët. Ky rregull zbatohet në çdo rast e për rrjedhojë dhe për vendimin të cilit i referoheni.	E plotë	S’ka
33	25.04.2025	Me datë 03.04.2025 kam depozituar përmes postës shqiptare ankimim vendimi të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr.248. Kërkoj	30.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj, ku kërkon informacion në lidhje me ankimin kundër vendimit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, nëse është	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		informacion nëse është regjistruar ky ankimim pranë gjykatës suaj, a është hedhur shorti për përzgjedhjen e gjyqtarit të çështjes si dhe a është përcaktuar data e seancës gjyqësore për shqyrtimin e ankimit.		regjistruar ky ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nëse është hedhur shorti dhe a është përcaktuar data e seancës gjyqësore për shqyrtimin e ankimit? Ju bëjmë me dije se: Sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe sekretarisë gjyqësore, rezulton se me datë 07.04.2025 është regjistruar ankimi juaj kundër vendimi të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr.248/2025. Me datë 08.04.2025 i ka kaluar gjyqtarit përkatës me anë të shortit elektronik. Ankimi i paraqitur nga ana juaj nuk ka datë të planifikuar akoma për shkak se referuar nenit 291, pika 3 të Kodit Pr.Penale, ku përcaktohet se; <i>“Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e gjykatës të kopjes së akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit të procedimit. Prokurori, jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e ankimit, i dërgon gjykatës një kopje të akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit...”</i>	
--	--	---	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Për këto arsye, dosja ndodhet në pritje të akteve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.		
34	28.04.2025	Në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të shtetasit A.B., kërkojmë informacion për datën e regjistrimit në gjykatë të kërkesës për pushimin e çështjes penale të paraqitur nga Prokuroria Lezhë, shortin dhe datat e seancave gjyqësore.	30.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj si përfaqësues me prokurë i shtetasit A. B., ku kërkon informacion në lidhje me kallëzimin penal si më poshtë: 1.Datën e regjistrimit të kërkesës në Gjykatë, 2.Shortin dhe datat e seancave gjyqësore. Ju bëjmë me dije se: Sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezulton se me datë 10.03.2025 është paraqitur kërkesa e Prokurorisë pranë kësaj gjykate për pushimin e çështjes penale nr.---/2017. Me datë 11.03.2025 i ka kaluar gjyqtarit me short elektronik. Me datë 09.04.2025 është planifikuar seanca e pare dhe me datë 06.05.2025 ora 09:00 është planifikuar seanca e ardhshme gjyqësore.	E plotë	S'ka
35	02.05.2025	Kërkoj informacion se çfarë është vendosur në çështjen me palë paditëse R.M. dhe palë e paditur B.M. me objekt “zgjidhje martese” e gjykuar me datë 30.04.2025 ora 11:15 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.	08.05.2025	Në lidhje me shqyrtimin e çështjes civile me paditëse R.M. dhe të paditur B.M. me objekt zgjidhje martese, ju bëjmë me dije se më datë 30.04.2025 është planifikuar seanca e parë e pajtimit konform nenit 134 të K.Familjes. Në këtë seancë nuk është konfirmuar marrja dijeni e palës paditëse, e për rrjedhojë nuk është zhvilluar duke u planifikuar	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				seanca e radhës më datë 14.05.2025, ora 11:30. Deri në seancën e radhës ju mund të paraqisni deklaratën e mbrojtjes në formën e kërkuar nga ligji, të nënshkruar nga ju ose përfaqësuesi juaj me prokurë si dhe provat mbi të cilat ju ngrini pretendimet tuaja. Provat duhet të jenë në formën e kërkuar nga ligji, origjinale ose kopje të noterizuara, në të kundërt nuk mund të merren në konsideratë nga gjykata. Nëse ju nuk mund të paraqiteni personalisht mund të caktoni një përfaqësues me prokurë sipas ligjit.		
36	05.05.2025	Ju kontaktoj në emër të Shoqërisë “—“ .Nëpërmjet këtij emaili kërkoj nga institucioni juaj pajisjen me vendimin e shkurtuar për çështjen me palë paditëse K.C., dhe palë e paditur Shoqëria “—“, për arsye se duhet ta paraqesim këtë vendim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.	06.05.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon vendimin e shkurtuar për çështjen me palë paditëse K. C. dhe palë të paditur Shoqëria “—“ shpk, për ta paraqitur në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bashkëngjitur këtij emaili ju vendosim në dispozicion dispozitivin e vendimit të datës 01.04.2025. <i>Shënim: Vendimi i arsyetuar do ju komunikohet me postë në adresën e përcaktuar në kërkesë padi.</i>	E plotë	S’ka
37	12.05.2025	Kërkoj informacion nëse është regjistruar ndonjë kërkesë për divorc në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në emër të O.P.	13.05.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon informacion nëse është regjistruar ndonjë kërkesë për divorc në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ju bëjmë me dije se: Pas verifikimeve në sistemin elektronik ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Përgjithshëm Lezhë, rezulton e regjistruar me datë 02.04.2025, kërkesë padia me paditës A. S., palë e paditur O.P., me objekt zgjidhje martese, e cila është në shqyrtim nga gjyqtar Renis Sheshi.		
38	26.05.2025	Si përfaqësues i palës paditëse kërkojmë informacion përse nuk është dërguar një kopje e vendimit civil nr.443-166, datë 19.2.2025, në Zyrën e Gjendjes Civile.	27.05.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kërkon informacion në cilësinë e përfaqësuesit të paditësit, se pse nuk është dërguar vendimi civil Nr. 443-166 date 19.2.2025, në Zyrën e Gjendjes Civile Orosh Mirditë, ju bëjmë me dije se: Sipas verifikimeve në kryesekretarinë e gjykatës vendimi civil nr.443-166 datë 19.2.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është dërguar për në Zyrën e Gjendjes Civile me datë 02.05.2025.	E plotë	S'ka
39	27.05.2025	Jam martuar në Lezhë. Aktualisht jetoj në Angli. Pas një viti që jam larguar më kanë shitur token dhe më kanë falsifikuar dokumentat dhe firmën time pa dijeninë time. Cfarë mund të bëj.	30.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se; Në lidhje me shqetësimin tuaj, ju mund të bëni kallëzim sipas nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale, në organin kompetent që është Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në lidhje me veprën penale të falsifikimit të dokumentave të cilën pretendoni që ju është bërë. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

40	30.05.2025	Unë, avokatja B.J., në cilësinë e mbrojtëses ligjore të shtetasit A. V., ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacion lidhur me kërkesën që kam dërguar me post për rivendosje në afat, të paraqitur për llogari të tij pranë gjykatës suaj. Ju lutem më konfirmoni: 1. Nëse kërkesa është administruar dhe regjistruar zyrtarisht nga ana e gjykatës; 2. Cilit gjyqtar i është caktuar nëpërmjet shortit kjo kërkesë; 3. Nëse është përcaktuar një datë gjykimi për shqyrtimin e saj.	10.06.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj si përfaqësuese e shtetasit A.V., ku kërkon informacion në lidhje kërkesën me objekt rivendosje në afat, ju informojmë si më poshtë: Sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezulton se më datë 26.05.2025 është regjistruar kërkesa me objekt rivendosje në afat. Me datë 27.05.2025 me anë të shortit elektronik çështja i ka kaluar gjyqtarit Aldi Kareco. Sipas verifikimeve në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk ka datë të planifikuar.	E plotë	S'ka
41	11.06.2025	Përcjellje për kompetencë -kërkesë për informacion.	12.06.2025	Në përgjigje të shkresës nr.2957/2 prot, datë 09.06.2025, së Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me nr.588 prot, datë 11.06.2025, ju dërgojmë informacionin përkatës lidhur me të dhënat e kërkuara. 1. Sa është numri i çështjeve në gjykim për të moshuarit që ju kanë humbur vitet e punës dhe që kanë hapur padi për pensionet? Sipas verifikimeve të bëra në regjistrat manual dhe sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezultojnë 29 çështje në gjykim. 2.Sa vendime u dhanë për vitin 2024 për padi pensioni? Sipas verifikimeve të bëra në regjistrat manual dhe sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezultojnë 170 vendime të dhëna me këtë objekt për vitin 2024. 3.Sa është numri i padive të divorceve në gjykim? Sipas verifikimeve të bëra në regjistrat manual dhe sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezultojnë 282 çështje në shqyrtim me objekt zgjidhje martese. 4.Sa çështje martesash janë zgjidhur gjatë vitit 2024? Sipas verifikimeve të bëra në regjistrat manual dhe sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezultojnë 723 çështje të përfunduara me objekt zgjidhje martese. 5.Statistika në lidhje me paditë për kompesim burgimi të padrejtë? Sa janë aktualisht dhe sa kanë qenë vitin e kaluar?		
--	--	--	--	---	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Sipas verifikimeve të bëra në regjistrat manual dhe sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk rezulton asnjë padi për kompesim burgimi të padrejtë për vitin 2024 dhe deri më tani për vitin 2025.		
42	12.06.2025	Në vijim të e-mailit të mëposhtëm, lutemi përcjelljen nga Gjykata juaj të informacionit të kërkuar, për vitin 2024, në kuadër të plotësimit të pyetësorit të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC).	25.06.2025	Në përgjigje të e-mailit tuaj lidhur me plotësimin e pyetësorit të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC), pyetësor i cili ka të bëjë me rastet e regjistruara/përfunduar për trafikim të qenieve njerëzore, në gjykatë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore për vitin 2024; Sa më sipër ju informojmë se nga verifikimet e kryera pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk rezulton të jetë regjistruar/përfunduar çështje me objekt trafikimin e qenieve njerëzore. Pra, për vitin 2024 në Gjykatën e Shkallën së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk rezulton të jetë regjistruar/përfunduar çështje për trafikim të qenieve njerëzore, për	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				rrjedhim nëse i referohemi fushave të tabelës për këto raste është 0 (zero).		
43	21.06.2025	Unë, Av.B.J., në cilësinë e përfaqësueses së znj. D. N. (palë e paditur), ju drejtohem me kërkesën e mëposhtme: Ju lutem të më vini në dispozicion nëpërmjet emailit: 1. Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, që i përket çështjes civile me objekt “zgjidhje martese”, ndërmjet palëve Y. N.(paditës) dhe D. N.(e paditur), me gjyqtar z. Aldi Kareco. Nëse vendimi nuk është zbardhur ende, ju lutem të më dërgoni dispozitivin e vendimit përkatës që lidhet me pushimin e çështjes. 2. Gjithashtu, kërkoj informacion nëse pala paditëse ka paraqitur një padi të re (ose të ngjashme) në vijim të kësaj çështjeje. Kjo kërkesë bazohet në ligjin nr.55/2018 " Për Avokatinë Republikën e Shqipërisë" në të drejtën për informim dhe përfaqësim të palës që përfaqësoj, në zbatim të parimeve të transparencës dhe garantimit të një procesi të rregullt ligjor.	02.07.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në rrugë elektronike në cilësinë e përfaqësueses së znj. D. N., ku kërkonti vendimin që i përket çështjes civile me palë paditësë Y. N. dhe palë e paditur D.N. me objekt zgjidhje martese dhe nëse pala paditëse ka paraqitur padi të re (ose të ngjashme) në vijim të kësaj çështjeje, ju sqarojmë si më poshtë: Së pari vendimin e kërkuar e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës në formë të anonimizuar automatikisht. Ju vendosim në dispozicion linkun e gjykatës në të cilin mund të aksesoni vendimin. Së dyti në lidhje me kërkesën nëse pala paditëse ka paraqitur një padi të re (ose të ngjashme), ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk rezulton të jetë regjistruar çështje tjetër në emer të shtetasve Y. N. dhe D.N.	E plotë	S’ka
44	01.07.2025	Në mbështetje të Ligjit nr.110/ 2016 “Për Falimentimin”, neni 12 pika 1	02.07.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj ku kerkoni vendimet gjyqësore		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		dhe 4 ,neni 203 pika d dhe VKM nr 542 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit” pika 4/ç , ju lutem të na dërgoni: 1.Vendimet gjyqësore të skanuara me objekt “<i>Kërkesë për hapje te procedurave te falimentimit</i>” për periudhen Mars- Qershor 2025 ; 2.Plotesimi i tabelës bashkëlidhur ; 3.Dergimin në vazhdimësi të cdo kërkesë per fillimin e procedures së falimentimit jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas detyrimit ligjor nga ana e sekretaris gjyqësore parashikuar ne ligjin 110/2016.		me objekt “<i>Kërkesë për hapje te procedurave te falimentimit</i>” për periudhën Mars-Qershor 2025 ju bejme me dije se, sipas verifikimeve të kryera në sistemin ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për periudhën Mars-Qershor 2025 nuk rezulton të ketë kërkesë me objekt “<i>Kërkesë për hapje te procedurave te falimentimit</i>”.	E plotë	S’ka
45	21.07.2025	Kërkesë për informacion. Në kuader te aktualitetit dhe interesit publik mbi aksionin e ndërmarrë nga qeveria qendrore dhe vendore njëkohësisht për çlirimin e hapësirave publike dhe aksionit mbi ndërtimet pa leje dhe legalizimet e tyre në kundërshtim me ligjin etj. Duke vlerësuar se rasti paraqet interes publik në raport me aktualitetin e zhvillimeve, bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar me ligjin nr.78/2023, datë 21.9.2023 kërkoj kopje të vendimit të gjykatës për	29.07.2025	Në përgjigje të kërkesën tuaj të dërguar në rrugë elektronike datë 21.07.2025 në email zyrtar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, kërkesë kjo e bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me të cilën kërkon vendimin për çështjen me objekt dërgimin në gjyq të çështjes penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a paragrafi 4 dhe neni 25 i Kodit Penal, ju informojmë se vendimin gjyqësor penal e gjeni të publikuar në portalin zyrtar	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		cështjen me objekt dërgimin në gjyq të cështjes penale, regjistruar nga prokuroria Lezhë për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a paragrafi 4 dhe neni 25 i Kodit Penal. Sa më sipër bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar me ligjin nr.78/2023, datë 21.9.2023, Kërkoj kopjen e këtij vendimi të gjykatës për gjykimin e rastit penal parashikuar nga neni 199/a paragrafi 4 dhe neni 25 i Kodit Penal dhe gjithashtu të më informoni nëse është ushtruar ankimi nga prokuroria.		të gjykatës në formë të anonimizuar automatikisht. Më sipër ju vendosim në dispozicion linkun e gjykatës në të cilin mund të aksesoni vendimin gjyqësor si dhe bazuar në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" vendimi gjenerohet automatikisht me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të cilat ndodhen të përshkruara në vendimin e mësipërme. Sjellim në vemendjen tuaj që të respektoni detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" duke qënë se shënjë gjyqësore është zhvilluar me detyrë të mbyllura dhe vendimi gjyqësor i kërkuar nga ana juaj përmban të dhëna personale në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".		
46	27.08.2025	Përcjellje për kompetencë	09.09.2025	Në përgjigje të shkresës nr.3619/2 prot, datë 01.07.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				të Përgjithshëm Lezhë me nr.688 prot, datë 02.07.2025, ju dërgojmë informacionin përkatës si më poshtë. Në lidhje me të dhënat e kërkuara ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra në të dhënat statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë rezultojnë se për vitin 2024 janë përfunduar 49 (dyzet e nënte) çështje me objekt shperblim demi dhe për vitin 2025 rezultojnë se janë përfunduar 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështje me objekt shperblim demi.	E plotë	S'ka
47	26.09.2025	Kërkesë për informacion dhe dokumentacion të kopjeve të vendimeve ndaj personave të akuzuar për vepren penale “Ndërtim i paligjshëm”.	29.09.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 25.09.2025, e paraqitur në mënyrë elektronike (e-mail), kërkesë kjo e bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me anë të cilës kërkon informacion dhe dokumentacion të kopjeve të vendimeve gjyqësore ndaj personave të akuzuar për vepren penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal për periudhen	E plotë	S'ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				kohore 2015-2025 ju informojme se: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk disponon material statistikor të përgatitur paraprakisht në lidhje me çështjet penale me objekt “Ndërtim i paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a Kodi Penal. Për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar nevojitet rishikimi dhe verifikimi ndaj çdo vendimi gjyqësor penal të regjistruar në gjykatë përgjatë periudhes 10- vjeçare, për të identifikuar në mënyre specifike çështjet penale me objekt “Ndërtim i paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a Kodi Penal, pasi është e pamundur gjenerimi automatikisht i këtij informacioni. Duke pasur parasysh ngarkesën e lartë të çështjeve për këtë periudhe kohore, mungesën e kategorizimit specifik në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, faktit që arkiva e gjykatës është zhvendosur në ish-		
--	--	--	--	---	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Gjykatën Kurbin, kërkojmë nga ana juaj që të specifikoni rastet konkrete për të cilat kërkon informacion apo dokumentacion, në mënyrë që tju vendosim në dispozicion të dhënat e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.		
48	08.10.2025	Sa i përket rasteve specifike, ne kërkojmë ato që kemi shkruar dhe në kërkesë sipas vitit përkatës. E kuptojmë volumin që mund të keni për sigurimin e informacioneve të tilla por ne ju bëjmë kërkesë pasi jo të gjitha informacionet janë të aksesueshme nga ana jonë në websiten tuaj.	23.10.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj e paraqitur në mënyrë elektronike (e-mail), kërkesë kjo e bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me anë të cilës kërkon informacion dhe dokumentacion të kopjeve të vendimeve gjyqësore ndaj personave të akuzuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal për periudhën kohore 2015-2025. Për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve për këtë periudhë kohore dhe mungesës së kategorizimit specifik të këtyre çështjeve në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, verifikimi i vendimeve gjyqësore për identifikimin e çështjeve penale me objekt	E plotë	S’ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				“Ndërtim i paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a Kodi Penal ka kërkuar kohë të gjatë. Për arsye të volumit të madh të vendimeve/numrit të vendimeve, ju informojmë se mund të paraqiteni të tërhiqni kopjet e vendimeve përkatëse pranë sekretarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çdo ditë hënë deri të premtën brenda orarit zyrtare të punës duke filluar ora 08.00 deri në orën 16.00, duke paraqitur një kopje të dokumentit tuaj të identifikimit. Gjithashtu, kërkojmë nga ana juaj si përfaqësues i medias që të respektoni detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar që gjenden në këto vendime gjyqësore.		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

² Data e regjistrimit të kërkesës.

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

⁴ Data e kthimit të përgjigjës.

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

⁶ Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar / E Refuzuar / E deleguar.

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.